



Në mbështetje të nenit 15 paragrafi 2. i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) 10/2022 për Kontrollimin teknik të automjeteve, departamenti i automjeteve shpallë këtë,

## NJOFTIM

Njoftojmë palët e interesuara se në komunën e Fushë Kosovës, Rahovecit dhe Prizrenit janë përmbushur kriteret për hapjen e Qendrës për Kontrollim Teknik siç është përcaktuar në nenin 89. të Ligji Nr. 05/L-132 Për automjete.

Palët e interesuara, kërkesat duhet ti dorëzojnë në arhivën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (ish Ndërtesa e Gërmisë).

Me rastin e dorëzimit të kërkesës pala e interesuar duhet të dorëzojë dokumentacionin siç është përcaktuar në nenin 15. Paragrafi 3. i Udhëzimit Administrativ (MMPHI) 10/2022 Për kontrollimin teknik të automjeteve. Projekti dhe hapsira duhet të jenë të punuara në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) 10/2022 Për kontrollimin teknik të automjeteve.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- Cerifikatën e biznesit,
- Lejen e ndërtimit,
- Lejen për kyçje në rrugë,
- Kopjen e parcellës në pronësi ose kontratë për shfrytëzim
- Projektin e qendrës për kontrollim teknik
  - o Listën e pajisjeve siç e përcakton Udhëzimit Administrativ (MMPHI) 10/2022 Për kontrollimin teknik të automjeteve.
    - Pajisjet duhet të jenë të reja - modele aktuale, ato nuk guxojnë të jenë të përdorura dhe të riparuar. Viti i prodhimit, jo më shumë se 2 vjet nga viti aktual.
    - Për pajisjen e testimit të frenave, duhet të dorëzohet raport i miratimit të tipit në përputhje me udhëzuesin e cilësisë dhe testimin e pajisjeve për testimin e frenave të lëshuara nga njëri prej instituteve të akredituara për këtë çështje (siç janë PTB, TÜV, NMI etj.), ....) si dhe autorizimin:
      - nga prodhuesi i pajisjeve te distributori i pajisjeve me raportin e niratimit të tipit për përdorimin e pajisjeve.
      - nga distributori i pajisjeve deri te konsumatori miratimin për përdorimin e tipit për përdorimin e pajisjeve.

- Për pajisjen e testimit të gazit dhe numëruesin e grimcave, është e nevojshme të dorëzohet raporti i miratimit të tipit në përputhje me udhëzimet e Direktivës 2014/32/EU - (MI-010) për pajisjen e testimit të gazit, d.m.th. kërkesat PTB 12.16 për numëruesi i grimcave, i cili duhet të lëshohet nga një institut i njohur (PTB, TÜV, NMI, etj.) dhe autorizimi:
  - nga prodhuesi i pajisjeve te distributori i pajisjeve me raportin e niratimit të tipit për përdorimin e pajisjeve.
  - nga distributori i pajisjeve deri te konsumatori miratimin për përdorimin e tipit për përdorimin e pajisjeve.
  
- Pajisjet duhet të kenë ndërfaqjen (interfejsin) në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kërkesat duhet të dorëzohen deri më 30 prill 2024.

Kërkesat e dorëzuara pas kësaj date si dhe ato me dokumnetacion të pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Prishtinë, më 3 prill 2024.